



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1873/Prot.

Tiranë më 25.11.2022

3

VENDIM

Nr. 30, datë 23.11.2022

“Për riorganizimin e programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, gërma “B”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë me shkresën nr. 778/1 prot., datë 13.07.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 23.11.2022;

VENDOSI:

1. Të riorganizojë programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore”, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të UT-së, sipas dokumentacionit bashkëlidhur, për vitin akademik 2023-2024.
2. Vendimi i Senatit Akademik t’i përcillet Bordit të Administrimit për veprim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

PROF. DR. ARTAN HOXHA